REPUBLIKA E SHQIPËRISË

GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Lënda: Mbi Raportin e Monitorimit për 4 mujorin e parë të vitit 2019

Në zbatim të kërkesave ligjore, bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 22, datë 17.11.2016, "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për njësitë e qeverisjes qendrore", ligjit nr. 88/2018 "Për Buxhetin e vitit 2019", udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018, "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", është hartuar për shqyrtim dhe miratim nga Grup i Menaxhimit Strategjik, relacioni dhe formatet standarde, si pjesë e strukturës së raportit të monitorimit të zbatimit të buxhetit.

Monitorimi është një proces vlerësimi performance, i cili realizohet nëpërmjet krahasimit të treguesve faktikë me ata të planifikuar. Në kuadër të menaxhimit financiar, monitorimit i kushtohet një vëmendje e veçantë si një nga 5 komponentët shumë të rëndësishëm të kontrollit të brendshëm. Monitorimi për veprimtarinë institucionale të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, për 4- mujorin e parë të vitit 2019, është kryer në kuadër të një analize krahasimore plan-fakt të zërave të shpenzimeve, dhe planifikimit të buxhetit në PBA-në (2019-2021).

Buxheti i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit për vitin 2019, është miratuar si pjesë e buxhetit të shtetit me ligjin nr.88/2018 "Për buxhetin e vitit 2019". Fondi total i miratuar për shpenzime korrente është 134,300 mijë lekë. Plani për periudhën 4/mujore është 47,860 mijë lekë dhe realizimi 36,908 mijë lekë ose 77%.

Në mënyrë të detajuar, realizimi i fondeve sipas artikujve kryesore, paraqitet në tabelën në vijim.

000/lekë

Programi	**Llogaria ekonomike**	**Emërtimi**	**Plani vjetor**	**Plani 4-mujor**	**Realizimi 4-mujor**	**% realizimit**
03340	6000000	Paga	96,000	37,640	31,761	**84%**
03340	6010000	Kontribute për sigurimet shoqërore, shëndetësore	8,300	3,320	2,794	**84 %**
03340	6020000	Mallra e shërbime	30,000	6,900	2,352	**34%**
		TOTAL	**134,300**	**47,860**	**36,908**	**77%**

I - Shpenzimet për paga (llogaria ekonomike 600)

Fondi i miratuar për paga, përbën 69% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2019. Buxheti i miratuar në paga, për periudhën janar- prill 2019, është 37,640 mijë lekë dhe realizimi 31,761 mijë lekë ose 84%. Realizimi në këtë masë është kryesisht rrjedhojë e mosplotësimit të strukturës organike. Konkretisht gjatë kësaj periudhe numri mesatar i punonjësve ka qenë 40 nga 43 të miratuar me vendimin e Kuvendit nr. 101, datë 04.10.2018, "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 92/2017 "Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit". Gjithashtu në këtë masë të realizimit të buxhetit, ka ndikuar edhe buxheti i parashikuar në këtë periudhë për pagesën me 1 pagë mujore, si vështirësi, për këshilltarët e Njësisë së Shërbimit Ligjor. Kjo pagesë nuk është kryer për këtë periudhë.

II - Shpenzimet për sigurime shoqërore (llogaria ekonomike 601)

Fondi i planifikuar për sigurime shoqërore dhe shëndetësore përbën 6% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2019. Buxheti i miratuar në zërin sigurime shoqërore, për periudhën janar- prill 2019, është 3,320 mijë lekë dhe realizimi 2,794 mijë lekë ose 84%. Fondi për sigurimin është i lidhur me marrëdhëniet e punësimit, dhe në përpjestim të drejtë me shpenzimet për paga, si rrjedhojë argumentat e nivelit të realizimit të fondit të pagave vlejnë dhe për këtë zë.

III - Shpenzimet për blerje mallra dhe shërbime (llogaria ekonomike 602)

Në këtë zë përfshihet një gamë e gjerë mallrash dhe shërbimesh të domosdoshme për mbështetjen e realizimit te veprimtarisë institucionale. Ky grup shpenzimesh përbën 21.6% të buxhetit vjetor të miratuar me ligj për vitin 2019. Buxheti i miratuar në shpenzime operative, për periudhën janar- prill 2019, është 6,900 mijë lekë dhe realizimi 2,352 mijë lekë ose 84%.

Në mënyrë analitike realizimi paraqitet në tabelën në vijim:

MALLRA DHE SHËRBIME TË TJERA	**Realizimi 4-mujor (në lekë)**
Materiale pastrimi e higjeno sanitare	**321,600**
Të tjera materiale dhe shërbime speciale (karta aksesi)	**1,800**
Shpenzime për energji elektrike	**496,236**
Shpenzime për furnizimin me ujë.	**8,470**
Shërbime telefoni mobile	**128,047**
Posta dhe shërbim korrieri + abonim në shtypin e shkruar	**44,807**
Shërbime printimi, publikimi (njoftime per shpallje te vendeve vakante)	**393,200**
Shërbime të tjera transporti (parkim për automjetin e institucionit)	**198,000**
Shpenzime udhëtimi jashtë shtetit	**383,440**
Shpenzime për honorare, pagesë ekspertë të jashtëm	**17,000**
Shpenzime kompesimi për zyrtarët e zgjedhur (shpenzime telefonie)	**315,000**
Shpenzime për tatim & taksa të paguara nga institucioni (taksat vendore)	**44,443**
TOTALI	**2,352,043**

Gjatë periudhës janar - prill, janë plotësuar nevojave e institucionit për: materiale pastrimi, shërbimi i telefonisë mobile për administratën, janë kryer pagesat për energji, ujë, shpenzime postare, taksat lokale të Bashkisë Tiranë për vitet 2017-2019 si dhe kamatë vonesa dhe interesa të llogaritura mbi to, për mos pagesë në afat të detyrimeve.

Në zërin "Shpenzime kompensimi për zyrtarët e zgjedhur" me vlerë 315,000 lekë, janë pasqyruar vlerat e kompensuara gjyqtarëve për shpenzimet e telefonisë mobile në vlerën 15, 000 lekë/muaj, sipas Vendimit të Mbledhjes së Gjyqtarëve nr. 2, datë 14.01.2019.

Në zërin "Shërbime printimi, publikimi", me vlerë 393,200 lekë, janë pasqyruar pagesat e kryera për shpallje në shtypin e shkruar të njoftimeve për vendet vakante (gjithsej 12 shpallje për 9 poste pune), sipas vendimarrjes së Komitetit Ad Hoc .

Në zërin "Shpenzime udhëtimi jashtë shtetit", në vlerë 383,440, janë pasqyruar shpenzimet e kryera për pjesëmarrjen e delegacionit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit në takimin e 11-të të Nënkomitetit Bashkimi Evropian - Shqipëri " Drejtësia, liria, siguria", në Brukses në datat 23-25 prill 2019. Shpenzimet e kryera për këtë aktivitet janë 199 mije lekë për bileta ajrore dhe 184 mijë lekë për akomodim në hotel dhe dieta.

Aktualisht janë në proçes likujdimi procedurat për furnizimin me tonera të institucionit, kancelari dhe letër, rimbushje- kolaudim fikse zjarri, plotësimi i sinjalistikes së zyrave sipas riorganizimit të stafit në muajin janar 2019 etj.

Nisur nga monitorimi dhe analiza e deritanishme e përdorimit të fondeve, është hartuar grafiku për ndjekjen me përparësi të zërave prioritar deri në fund të vitit, me qëllim plotësimin e nevojave për mallra dhe shërbime si dhe përdorimin me eficensë të buxhetit.

IV. Investime kapitale

Buxheti i miratuar në investime, për periudhën janar- prill 2019, është 4,700 mijë lekë, për projektet si vijon:

000/lekë

Kodi i projektit	**Emërtimi i projektit**	**Plani i buxhetit viti 2019**	**Realizimi (4-mujori I/ 2019)**
M630002	Blerje pajisje dhe mobilie zyre	730	0
M630013	Blerje pajisje elektronike	870	0
M630021	Softëare formatimi vendimesh gjyqësore	100	0
M630022	Sistem video salle gjyqi	3.000	0
TOTALI		**4, 700**	**0**

1. Aktualisht ka përfunduar procedura e prokurimit për plotësimin e nevojave për punonjësit me pajisje si tavoline pune , arshive metalike, aparat telefonik etj.
2. Gjithashtu ka filluar procesi i konsultimit për marrjen e informacionit per përcaktimin e termave të referencës per sistemin video ne sallen e gjyqit.

Duke marre parasysh qe salla e gjyqit eshte shume e vogel ne permasa dhe e pamjaftueshme per te pozicionuar te gjitha kamerat, fillimisht u diskutua qe ne nje ambjent tjeter, jashte sallës se gjyqit te mundesonim me fisha disa plane live te zhvillimit te seances, per t'ua vene ne dispozicion mediave ne kohe reale. Qellimi i ngritjes se sistemit audio - video mendojmë te jete kryesisht arkivor, pasi eshte e domosdoshme te kemi ne arkiven institucionale seancat audio-video.

3. Për pajisjet elektronike, jemi në fazën e evidentimit të nevojave për zhvillimin e procedurës së prokurimit.
4. Sa i takon parashikimit te kryer per "software formatimi vendimesh gjyqësore", nga konsultimi i specialistit IT, me operatoret e tregut, rezulton se kosto per kete program është

rreth 120 mijë lekë në formën e licensës së rinovueshme vjetore. Nga operatoret nuk ofrohet blerja e softit, e për rrjedhojë ky shpenzim nuk të trajtohet si investim por si nje shërbim që mbulohet nga zëri i shpenzimeve operative.

Duke ju falenderuar për vëmendjen.